

ALMIRA SADIKAJ

**SINTAGMA FOLJE + MBIEMËR NË VËLLIMIN
“PELEGRINI I VONUAR” I DRITËRO AGOLLIT**

Dritëro Agolli, ky shkrimtar i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore, i cili në letërsi fillimisht hyri si protagonist i saj, më pas u përpoq për të ndryshuar përmasën e së ardhmes, dhe shumë shpejt u bë një prej figurave më të respektuara për publikun e gjerë, pra një ndër figurat qendrore të poezisë shqipe. U dallua si një ndër shkrimtarët që në tërë veprimtarinë e tyre krijuese u mbështetën në tabanin kombëtar, në gjuhën dhe kulturën e popullit¹, ku shfrytëzuan më efekt gjithë materialin e vjelë nga gurra popullore. Dritëroi lëvroi pa reshtur poezinë në gjithë larminë e saj: *poezinë e shkurtër, poemën, baladën, fabulën, sonetin*, etj., por ajo çka e bëri mjeshtër ishte poezia. Lidhur më këtë të fundit, Moikom Zeqo shprehet se: “Poezia në krijimtarinë e D. Agollit është gjëja më e çmuar, por jo e vetmja²”, kjo, për faktin se Agolli nëpërmjet veprës së tij realiste e me vlera të veçanta të artit letrar, shpeshherë me satirë të mprehtë e humor të hollë, e ndonjëherë edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, ka paraqitur në mënyrë shumë artistike të vërtetën për jetën dhe kohën. Poezia e tij është e afërt me njeriun, gjë që e bën Agollin poet të tokës dhe të dashurisë për të, e klasifikon si një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm e më të spikatur të letërsisë shqipe, një poet prodhimtar e cilësor, si autor i veprave të shumta të përfunduara e të pa plotësuara, si poet idealist, ëndërrimtar e shtegtar i përjetshëm³.

Dritëro Agolli u konsiderua si poet individualist, i cili çmontoi klishetë e vjetra poetike, çkanonizoi vjershërimin e traditës dhe njëherësh krijoi një traditë të re për poezinë shqipe. Sh. Sinani në “Njeriu dhe dukuria atipike në veprën e D. Agollit”, i kujton lexuesit se poezia e D. Agollit njohu një

¹ T. Osmani – M.Gero, *Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit*, “Gjuha jonë” 1, 1991, f. 32.

² M. Zeqo, *Liriku i tokës, Demon i fjalës*, Botimet Toena, Tiranë, 1996, f. 31.

³ R. Zisi – L. Boçi, Dritëro Agolli dhe letërsia shqipe, *Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Dritëro Agolli, Personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare”*, Gjirokastër, 2013, f. 17.

ringjallje poetike në dy dekadat e fundme.⁴ Këtu poeti u përpoq të rigjejë vlerën dhe kuptimin e jetës së vet dhe të brezit të vet. Nëpërmjet përjetimeve të tij, ai provoi të krijonte poezi antologjike me motive të përditshmërisë së jetës, duke ndryshuar përfytyrimin për jetën dhe duke zgjeruar hapësirën e realitetit në poezi. Ideja dhe tematika në krijimtarinë e tij e përkufizojnë Dritëroin si letrari inteligjent, si zot dhe rob i fjalës, si mjeshtër i figurës dhe i mendimit, si krijues i frymëzimit filozofiko – metafizik, pra një individualitet poetik i rrallë me vlera universale. Veprat e tij janë përkthyer në mjaft gjuhë të botës. Duke qenë se Dritëro Agolli njihet për krijimtarinë e tij të larmishme poetike, me vlera të rëndësishme jo vetëm fonetike, fjalëformuese leksikore por edhe për strukturat e veçanta sintaksore, kemi menduar të studiojmë disa sintagma foljore (predikative) + mbiemër, duke i klasifikuar edhe sipas funksioneve me të cilat ato dalin. Fillimisht po japim një interpretim të shkurtër rreth foljeve, sintagmave foljore (predikative) + mbiemër.

•Rreth foljeve dhe sintagmave foljore

Në fushën e gjuhësisë shqiptare dhe kryesisht në gramatologjinë shqiptare, folja dallohet nga pjesët e tjera të ligjëratës sidomos nëpërmjet kategorive gramatikore. Ajo ka kategori gramatikore që nuk i ka asnjë pjesë tjetër e ligjëratës (diatezë, mënyrë dhe kohë). Kategoritë e vetës e të numrit të folja ndryshojnë, pasi këto dy kategori gramatikore kanë karakter sintaksor, kushtëzohen nga veta dhe numri i kryefjalës, e si rrjedhim nuk sjellin ndonjë ndryshim në kuptimin leksikor të saj. Për konceptin e foljes në "Gramatikën e Akademisë"⁵, thuhet se: folja emërton një veprim si proces dhe ka kategoritë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës dhe diatezës. Por, përveç kategorive gramatikore, folja shpreh edhe funksione sintaksore të cilat janë të përdorshme në të gjitha stilet e gjuhës. Funkcioni i kallëzuesisë (predikativitetit) sipas Rami Memushaj, është "një tipar themelor i fjalisë që përfaqëson një referim të realitetit"⁶, pra, quhet kallëzuesi, pasi kallëzuesi (predikati) është gjymtyra që lidh përmbajtjen e fjalisë me botën e jashtme. Duke qenë se folja përbën boshtin e kallëzuesisë, ajo e vendos veprimin e kumtuar nga fjalia në një kohë të caktuar (kuptimi kohor), dhe e paraqet atë si real, si të dëshiruar, si urdhër

⁴ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, "Studime", Shtëpia botuese "Naimi", Tiranë, 2008, f. 269.

⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2002, f. 260.

⁶ R. Memushaj, Dorëshkrim "Bukuria e gjuhës 2", 2008, f. 14.

etj. Por, ka raste kur folja mungon në fjali, edhe në këto raste ajo nënkuptohet, kështu që kallëzuesia realizohet, d.m.th. nuk ka fjali pa kallëzues. Për shprehjen e kallëzuesisë së fjalisë janë të domosdoshme kategoritë e kohës dhe të mënyrës.

Në "Gramatikën e Akademisë" kallëzuesi merret si një ndër gjymtyrët kryesore të fjalisë, megjithëse gramatikusht është gjymtyrë përcaktuese. Duke u mbështetur dhe në gramatikat e ndryshme dhe studimet në lidhje me këtë problem pohojmë se mbiemri në funksion predikativ krijon lidhje sintaksore të dyfishta: lidhjen e parë sintaksore e krijon me një sintagmë emërore në funksion të kryefjalës a të kundrinës, kurse lidhjen e dytë e realizon me kallëzuesin (foljen). Në funksion predikativ, kjo lidhje e dyfishtë e mbiemrit në kushtëzohet nga valenca e foljeve, sepse jo me të gjitha foljet mbiemri mund ta realizojë këtë funksion në fjali. Folje të cilat i japin mbiemrit funksionin kallëzuesor janë: *emëroj – emërohem, gradoj – gradohem, ngarkoj – ngarkohem, propozoj – propozohem, mbaj – mbahem, iki, ndiej, kërkuj, fut – futem, zë – zihem, shkruaj, vesh – vishem*⁷, etj.

Veçori e foljeve është se ato kanë lidhje të ngushtë me konceptin e kalimtarësisë e jokolimtarësisë, për arsye se kanë në strukturën e tyre folje me kuptim kalimtar ose jokolimtar. Të qenit folje me kuptim kalimtar ose jokolimtar është një veti ose aftësi e brendshme e këtyre foljeve, pra ajo nuk diktohet nga ndonjë mjet gramatikor ose jogramatikor. Këto dy kuptime kanë karakteristikat e tyre. Sipas Gramatikës së gjuhës shqipe, I⁸, quhen kalimtare ato folje, të cilat emërtojnë veprime, që nuk mbeten tek ai që i kryen, por shkojnë e bien mbi një person a send tjetër, që në fjali shprehet me anë të një emri, përemri a çdo fjale tjetër të emëruar në rasën kallëzore pa parafjalë. Folje kalimtare, pra, quhen ato që kanë mundësi të marrin kundrina. Kalimtarësia është trajtuar si karakteristikë e një sintagme të tërë, ku një veprim është kryer ose transferuar nga një veprues te një pësues. Sipas tij, kuptimi leksikor i foljeve ndikon në mënyrën e shprehjes së kallëzuesorit. Duke u nisur nga kriteret strukturore e kuptimore si dhe funksioneve që përmbushin, në gramatikën e akademisë dhe gramatikën e M. Çelikut dallohen gjymtyrë të ndryshme, ndër to gjymtyrë kryesore, kryefjala dhe kallëzuesi, që përbëjnë qendrat organizuese të fjalisë: lidhja e tyre përbën bërthamën e saj: ndërsa gjymtyrët e quajtura të dyta janë

⁷ Th. Dhima, *Gjuha Shqipe Sintaksa*, Gjirokastër 2010, f. 126.

⁸ *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 265.

plotësuese, herë pas here edhe të domosdoshme. Në lidhje me analizën e strukturës së përbërësve në fjali, Rami Memushaj në "Gjuhësia Gjenerative"⁹ përforcon mendimet e Çomskit dhe gjenerativistëve të tjerë. Në bazë të analizës funksionale zbulon sintagmat dhe lidhjet gramatikore midis përbërësve. Sipas tij, kjo lloj gramatike bën dallimin ndërmjet sintagmës dhe togfjalëshit. Sintagmat identifikohen nga modelet e tyre të shpërndarjes dhe zakonisht funksionojnë edhe si njësi semantike në të njëjtën kohë. Ashtu si fjalët, sintagmat klasifikohen në përgjithësi në kategori; kategoritë më të përdorshme janë, p.sh., sintagma emërore (SE/NP), sintagma foljore (SF/VP), sintagma parafjalore (SP/PP) – të cilat rrjedhin nga kategoritë e fjalëve që shfaqen si bazë. Këto fjalë janë "kokat leksikore" (ose ndonjëherë vetëm "kokat") të sintagmave. Po të vëmë re studimet e shumta që janë bërë për togfjalëshin dhe sintagmën, shohim se në gramatikat tradicionale koncepti togfjalësh është më i përdorshëm, ndërsa, për analogji në gramatikën gjenerative përdoret koncepti sintagma. Sipas R. Memushaj sintagma mund të përbëhet nga dy a më shumë togfjalësha, po mund të jetë edhe një fjalë e vetme¹⁰, pra që do të thotë se nuk ka sasi të caktuar fjalësh që e përbëjnë vëllimin e saj. Në fjalorin e jetës së përditshme, zakonisht, kur përmendim termin grup fjalësh na vjen në mendje termi "shprehje". Në gjuhësi, kjo shprehje formon një njësi bazë dhe funksionon si një e tërë në sintaksën e një fjalie. Organizimi i fjalëve të një gjuhe në një fjali, në mënyrë hierarkike quhet sintagmë¹¹. Për studiuesin Th. Dhima, termi përbërës ose grup fjalësh është përdorur si e barasvlershme me termin sintagmë (nga greq. σύνταγμα, "vendosje, rreshtim")¹². Sipas tij përbërësit ose sintagmat janë të madhësive të ndryshme, nuk ka kufizime në përcaktimin e vëllimit të tyre, që nga përbërësit e një madhësie më të lartë deri te fjalët e vetme. Por, ndryshe nga fjalët të cilat janë kategori leksikore, sintagmat janë kategori sintagmatike me bazë një kokë, sipas së cilës emërtohet vetë sintagma. E rëndësishme është dhe vendosja e raporteve kuptimore midis përbërëse, si dhe marrëdhëniet midis sendit, tiparit dhe cilësisë së tij. Në të dyja gramatikat si tradicionale dhe atë gjenerative, fjalia zë vend si njësi

⁹Shih më gjerë R. Memushaj, *Gjuhësia Gjenerative*, "Gramatika e strukturës së sintagmës", SHBLU, Tiranë, 2008, f. 108.

¹⁰ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 260.

¹¹ Th. Dhima, *Gjuha Shqipe Sintaksa*, Gjirokastrë 2010, f. 22.

¹² Th. Dhima, Po aty, f. 29.

themelore sintaksore, si mjeti e mënyra kryesore e formësimit, shprehjes dhe e kumtimit të mendimit.

Në vëllimin me poezi "Pelegrini i vonuar" dallojmë praninë e një numri të madh formash foljore + mbiemër të cilat na dalin në funksione të ndryshme sintaksore në fjali.

Çdo mbiemër pa dallim është i specializuar për të emërtuar një cilësi, tipar, veti a karakteristikë të një sendi, frymori a dukurie: Ah, kjo cigare që pi **është e fortë**, E ndiej kur në gjoks më shtrëngon. (Pelegrini i vonuar, f. 12), - E di asgjë s'ke ç'të bësh, tani **jam i tharë**, Një pemë e zhveshur prej gjelbërimit, Megjithatë pak nga lëngu yt kam për të marrë, Unë, ky tra i tharë nën murin e mjerimit (Pelegrini i vonuar, f. 17), Tani për asgjë s'kam dëshirë, U drodh çka **ishte e shenjtë** për mua. (Pelegrini i vonuar, f. 45) etj. Në të gjithë këta shembuj cilësia, vetia a karakteristika e sendit, frymorit, dukurisë a veprimit jepet me anë të mbiemrit si një veçori jashtë çdo krahasimi, pra si tipar, cilësi a karakteristikë e pakrahasueshme.

- Nisur nga funksionet të cilët marrin mbiemrat në gjuhën shqipe ka mendime të ndryshme. Për këtë arsye dhe në lidhje dhe me materialin që ne kemi vjelë, mbiemrat në veprën e Agollit i kemi parë dhe analizuar vetëm në marrëdhënie predikative, pra në funksionin sintaksor predikativ, i cili paraqitet më i ndërlikuar. Mbiemri në funksion predikativ është i domosdoshëm; siç mund të shihet edhe nga këta shembuj, foljet nuk mund të qëndrojnë më vete, gjë që përbën një provë më shumë se mbiemri është pjesë e kallëzuesit. Mungesa e mbiemrit në funksion predikativ bën që fjalitë të shndërrohet në fjali jogramatikore. Kjo vlen jo vetëm për rastet kur mbiemri del pas një foljeje në veprorë ose pësorë, po edhe kur del si **kallëzues emëror** pas foljes ndihmëse jam. Kallëzuesi emëror, sipas nesh, do të duhej të përfshihej në kuadër të kallëzuesorit (predikativit), sepse, shtrohet pyetja: a nuk krijohen raporte predikativiteti (kallëzuesie) edhe në fjalitë që në gramatikën akademike dhe në gramatikën e M. Çelikut konsiderohen kallëzues emërorë edhe ato folje që u afrohen kuptimisht kuptimit të foljes jam. p.sh.: Djali u bë i mirë. Ai u emërua nëpunës¹³.

- Ndërtimet e tipit folje + mbiemër janë tipike për mbiemrat në funksion predikativ, gjë që e vë në dukje edhe M. Çeliku, i cili thekson se në rastet e mbiemrave që dalin në funksion kallëzuesor, foljet me të cilat përdoren "janë të shkuptimësuar; ato kanë nevojë të domosdoshme të plotësohen semantikisht nga përbërësit vijues. Kjo do të thotë se ndërtime të tilla merren si pjesë e kallëzuesit emëror dhe fjalive këpujore. Sipas këtij

¹³ M. Çeliku, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, ILAR, Tiranë, 2012, f. 156.

koncepti, fjalitë këpujore shtohen, sepse në radhën e tyre përfshihen jo vetëm ato që përmbajnë foljen këpujë jam, por edhe disa folje të tjera të shkuptimësuar, gjithashtu këpujore, si: **kam, bëj, dukem, emërohem, gjej, mbes, ndjehem, shpallem** etj. P.sh.: - Kur dielli **rrinte heshtur** në kupën e qiellit, Një kalë i bardhë kalonte lehtë (Pelegriini i vonuar, f. 19), - Po historia u jep nga një kafe në këmbë, Dhe **thotë e përmbajtur** diçka nëpër dhëmbë: "Na falni, se presim në sofër të vijnë, Ata që bëjnë vërtet historinë" (Pelegriini i vonuar, f. 28), Dhe skuqjen e tyre naive të pastër. Tani fytyrat tona **u bënë të paturpshme** (Pelegriini i vonuar, f. 61), - Ta pinim verën me vajzat e ishujve në belvedere, Zezaku **të bënte fresk** me fletën e palmës (Pelegriini i vonuar, f. 97), Erdh koha të mësoj diçka tjetër. Mësova të pi sisë e të ngrihem në këmbë, Mësova **të bëhem i ri dhe i vjetër**, Mësova të plakem, të heq e të vë dhëmbë... (Pelegriini i vonuar, f. 64). Në qoftë se i referohemi teorisë së valencës dhe roleve tematike, atëherë duhet të vëmë në dukje se folja jam është njëvalente, ajo shkarkon një rol dhe vetëm një rol, P.sh.: - Ndaj në udhë **jam krejt i humbur, jam fillikat**, Me shami të grisur lidhur në kokë (Pelegriini i vonuar, f. 7), Mes tymit të hirtë, Dhe thoshte: "Mosni, or njerëz, Se guri **do të jetë më i rëndë**, Kur kishat t'i ngrini sërishmi nesër, Nëse do t'ju vijnë pak mëndtë"! (Pelegriini i vonuar, f. 27), Si shkuam kur **ishte i gjallë**, tani është vonë, Qëndrojmë në këmbë në dhomën e ftohtë dëborë... (Pelegriini i vonuar, f. 53), - U lodha! Kush më thotë një fjalë të mirë, **Qoftë të rremë** për të më prehur? Nuk jam njeri dhe aq i vështirë, **Bëhem i lodhshëm**, kur **jam pak i dehur**. (Pelegriini i vonuar, f. 54), -Unë **rrri i pagjumë** netëve vonë, Me një mackë që e kam rritur vetë, (Pelegriini i vonuar, f. 59), Vërtet **jam i ri** pa rrudha e thinjë, E lashë gjysmën e viteve në torbë (Pelegriini i vonuar, f. 62), Për mua **s'është e vështirë**, Në vargjet **të njoh symbyllur sinorët e pragjet**. (Pelegriini i vonuar, f. 84), Prandaj **është e bardhë**, prandaj **është e re**, Se zhurmë me pluhur nuk ngre... (Pelegriini i vonuar, f. 205).

- Në rastet si: Kujdes me fjalën, zonjës me çantë, Kujdes me fjalën dhe ti zotëri! Pushteti i fjalës **është i veçantë**, Gatuan male dhe kakërdhi. (Pelegriini i vonuar, f. 65), Bari **është i ndershëm** dhe i thjeshtë, Bari s'humb diçka mëson përditë, (Pelegriini i vonuar, f. 109), Njerëzit mendojnë se **jam i begatë**, Me garderoba të fryra. (Pelegriini i vonuar, f. 131), etj. shihet qartazi, nga shembujt se kemi kallëzuesorin e kryefjalës, sepse mbiemri në këtë funksion përcakton kryefjalën (pra, jep një tipar, karakteristikë të kryefjalës) dhe hyn në raporte rrethimore me kallëzuesin foljor.

• Mbiemri kur del në funksion predikativ është në distancë, bën përjashtim kur është në funksion të kallëzuesorit të kundrinës së drejtë (që mund të dalë afër kokës dhe larg saj), në këtë rast mbiemri përcakton kundrinorin (pra, jep një veçori, tipar a karakteristikë të objektit). p.sh.: Dhe mos e **quaj arkaik e vjetërsirë** zjarrin, Zbuluesi i Zjarrit ishte kaq model një ditë (Pelegrini i vonuar, f. 107), Po gjer tani e shoh se jam mirë, Më duket s'kam sklerozë e vdekje në vargjet, Vështron në dritare, **kalon e drojtur** pragun, E dobët, e mitur, e lehtë (Pelegrini i vonuar, f. 101), Në një shkëmb **qëndron i gjori, Shokët deti i shkretë i mori** (Pelegrini i vonuar, f. 131).

Dhe **isha dëshmitar** i fronave të shkrumbtë, Të mbretërve që gërmadhave binin, kur ju sapo lindnit (Pelegrini i vonuar, f. 125). Në këtë rast kemi sintagmë foljore në funksion të kallëzuesorit, pavarësisht që në këtë rast është shprehur me emër, ka kuptim mbiemëror dhe përshtatet në gjini, numër dhe rasë fjalës së cilës i referohet.

• Ka disa raste kur mbiemri në funksion të kallëzuesorit, merr gjininë e kryefjalës, pavarësisht që në gjuhën shqipe, kryefjala mund të mos shprehet fonetikisht, por ajo është e nënkuptuar. Ky është një parametër që e dallon shqipen nga gjuhët e tjera të familjes indoeuropiane, ku kryefjala domosdoshmërisht duhet të realizohet fonetikisht, përndryshe fjalia është jogramatikore. Me krye në duar **qëndroja i heshtur**: Pak kohë më parë nëna ime kish vdekur (Pelegrini i vonuar, f. 130), Qëlloni me fjalë e goditni me hekur, Unë **jam i pavdekshëm** përgjersa s'kam vdekur. (Pelegrini i vonuar, f. 143), Këto i di njeriu i shkretë, Dhe mezi fle dhe **s'është i qetë**, (Pelegrini i vonuar, f. 148), Po qaja... Kish ardhur fëmiria, Jastëku i zhubrosur **ishte i lagur**, (Pelegrini i vonuar, f. 204), Do jetë siç ishte më parë, Do **ketë të rinj** edhe pleq (Pelegrini i vonuar, f. 150).

• Një grup tjetër është edhe formimi i sintagmave foljore të ndërtuara nga folje kuptimisht të përafërta semantikisht me këpujën jam. Në këtë grup hyjnë edhe foljet si: *bëhem, mbes, gjendem, gjej, dukem*, etj. Ja disa shembuj të mbiemrave në funksion predikativ të shkëputur nga vepra e D. Agollit: Goditja jote pa cip ndaj fatesh në botë, **Mbetet e turpshme** përjetë!... (Pelegrini i vonuar, f. 153), **Jam i mbushur** me vajtime dhe i zbrazem Marmarasë, Ku turkesha thyen gishtin në një tel të tamburasë, **Mbetur fillikat** pa shokët, Hidhet përmbi valët vetë... (Pelegrini i vonuar, f. 172) Buzëqeshja **mbetet e helmuar**, Pikëllimi- lodhje e përgjumur, (Pelegrini i vonuar, f. 212), Gjyshi i shkretë ndaj Haxhi Bektashit, **Rrinte sus** si unë para Marksit (Pelegrini i vonuar, f. 106), S'e dimë pse ballin me

zhubra e rrudhi, Veç dimë që shihte e plakur qershinë... (Pelegri i vonuar, f. 115).

Si përfundim, mund të theksojmë se sintagmat folje + mbiemër në shqipe kanë aftësi të krijojnë lidhje sintaksore dyfarëshe. Nga kjo rrjedh se funksioni predikativ i mbiemrit është: a) në funksion të kallëzuesorit të kryefjalës (predikativi i kryefjalës), dhe b) në funksion të kallëzuesorit të kundrinorit të drejtë (predikativi i kundrinorit të drejtë).

Dukë qenë se marrëdhënia e predikativitetit është një raport sintaksor ndërvaresie, atëherë si kur del në funksion të kallëzuesorit të kryefjalës, ashtu edhe kur del si kallëzuesor i kundrinorit, mbiemri, kur është i nyjshëm, përshtatet në gjini, numër dhe në rasë. Kjo ndërvaresi nuk krijohet vetëm midis sintagmës emërore në funksion të kryefjalës dhe kallëzuesit foljor, por edhe midis kallëzuesorit të shprehur me mbiemër që së bashku me foljen përbën sintagmën foljore.

BIBLIOGRAFI

- Çeliku, M., *Sintaksa e gjuhës shqipe*, ILAR, Tiranë, 2012.
- Dhima, Th., *Gjuha Shqipe, Sintaksa*, Gjirokastër, 2010.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.
- Memushaj, R., *Gjuhësia Gjenerative*, “Gramatika e strukturës së sintagmës”, SHBLU, Tiranë, 2008.
- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004.
- Osmani, T. – Gero, M., *Mendime për gjuhën dhe stilin e Dritëro Agollit*, “Gjuha jonë”, 1, 1991.
- Sinani, Sh., *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, “Studime”, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2008.
- Zeço, M., *Liriku i tokës, Demon i fjalës*, Botimet Toena, Tiranë, 1996.
- Zisi, R. – Boçi, L., Dritëro Agolli dhe letërsia shqipe, *Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Dritëro Agolli, Personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare”*, Gjirokastër, 2013.